



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:017973  
Datë: 04.12.2023  
Numri i dokumentit: 05008581

C-IV.-13-1440

*Ankuesi*

M Z, Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatja A S.

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë- Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtar Shkelzen Sylaj, me 04 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN127-0061, i datës 04 korrik 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 05 gusht 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN127-0061, të datës 04 korrik 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensim për paga të papaguara në shumën prej 18,900.00 Euro nga NSH “Ekonomia Peshkatare” (në likuidim), për periudhën kohore nga 1997 deri me 15 mars 2006. Ankuesi ka pohuar se, e paraqet ankesën për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale. Gjithashtu ankuesi ka pohuar se, në kohen e sundimit të regjimit të Serbë, i cili regjim mbi bazën e shkeljes së të drejtave elementare njerëzore dhe të diskriminimit mbi bazën e politikës nacionale, e ka bërë ndryshimin statusor të ish NSH “Ekonomia e Peshkatarëve” e ka bashkuar me NSH “Yuko – Dubrava” në Istog. Ne këtë rast parashtruesit dhe punëtorëve të tjerë është dashur t’ju paguhet paga mujore nga NSH “Yuko – Dubrava” sepse ka qenë obligim ligjor i këtij

subjekti ekonomik. Ankuesi i ka propozuar Gjyaktës që të merret një vendim i drejtë dhe ligjor në çështjen e parashtruar.

Me 11 korrik 2014, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkëlur nga AL në marrjen e vendimit. Ka theksuar se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuara (publikuara ne Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1967) i aplikueshëm sipas nenit 1 të rregullores së UNMIKU-ut 1999/24. Më tej e paditura pohoi se një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi duhet të jetë paraqitur para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 15 gusht 2014, përfaqësuesi i ankuesit është përgjigjur udhërit për përgjigje në mbrojtjen e të paditurës. Ankuesi e kundërshtoj përgjigjen e AKP dhe mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës.

Me 19 shtator 2014, AKP ka paraqitur kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së parashtruesit të dorëzuar me 15 gusht 2014, duke konfirmuar pohimet dhe qëndrimin ligjor të paraqitur në mbrojtje.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN127-0061, i datës 04 korrik 2013, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

*kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo*

*në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;*

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së. Dispozita e nenit 608 parashikon se kërkesat monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen për 3 vite.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohen dispozitat e atij Ligji. Gjykata gjithashtu vëren se me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili hyri në fuqi më 01 nëntor 2010, në dispozitat e tij qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha Ligjeve ekzistuese të Punës në Kosovë. Megjithatë, ky Ligji nuk parashihet parashkrim në lidhje me pagesat e të ardhurave, prandaj baza ligjore duhet kërkuar në legjislacionin në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999 e cila siç u tha më lartë në nenin 1.1 pika b, parashihet si Ligj në fuqi në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989.

Lidhur me parashkrimin rregullat e njëjta gjinden edhe në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978 i cili ishte në fuqi deri me hyrjen në fuqi më 19 dhjetor 2012 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që N.SH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 18,900.00 Euro nga NSH “Ekonomia Peshkatore” për periudhën kohore nga viti 1997 deri më 15 mars 2006 e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 23 maj 2013, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara për periudhën 1997 deri më 15 mars 2006, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagën e fundit ka arritur në mars të vitit 2009, ndërsa ankuesi kërkesën e ka parashtruar me 23 maj 2013, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor.

Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar